

Hapet thirrja për bursa për stafin me kohë të plotë për mësimdhënie/trajnim në Universitetin Kodolanyi Janos, Hungari në kuadër të Programit Erasmus +.

Në kuadër të Programit Erasmus + është hapur thirrja për aplikime për bursa për mobilitete për stafin akademik/stafin ndihmës akademik me karakter administrativ/stafin administrativ me kohë të plotë të Universitetit të Tiranës në Universitetin Kodolanyi Janos, Hungari.

<http://edu.kodolanyi.hu/>

Llojet e mobilitetit përfshijnë:

-Mësimdhënie për stafin akademik (stafi akademik mund të japë leksione edhe gjatë Javës Ndërkombëtare të Trajnimit);

- Trajnim për stafin stafin ndihmës akademik me karakter administrativ/stafin administrativ me kohë të plotë (në Javën Ndërkombëtare të Trajnimit, 30 Mars – 3 Prill 2020);

Pjesëmarrja në këto aktivitete ka një fee, të përcaktuar nga universiteti pritës.

Për më shumë informacion, referohuni linkut:

<http://edu.kodolanyi.hu/academics/international-week/>

Kohëzgjatja e mobilitetit:

- 5 ditë + 2 ditët e udhëtimit;

Bursat përfshijnë:

- Kompensimin ditor 140 Euro;

- Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës)

DISTANCA E UDHËTIMIT (http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm)	Kompensimi
Midis 100 dhe 499 KM	180 EUR
Midis 500 dhe 1999 KM	275 EUR
Midis 2000 dhe 2999 KM	360 EUR
Midis 3000 dhe 3999 KM	530 EUR
Midis 4000 dhe 7999 KM	820 EUR
8000 KM ose më shumë	1100 EUR

Për të përcaktuar distancën ju lutem referohuni link-ut:

http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm

Dokumentet e nevojshme për aplikim për stafin me kohë të plotë:

- CV+ Lista e publikimeve (vetëm për stafin akademik), (në gjuhën angleze);
- Kopje e Pasaportës;
- Letër motivimi (në gjuhën angleze);
- Vërtetim Punësimi (në gjuhën shqipe);
- Certifikata e gjuhës së huaj që vërteton njohuritë e gjuhës angleze në nivelin B2;
- Vetëdeklarim nëse kenikryer apo jo më parë një shkëmbim Erasmus+ (nëse po, ku);
- Dokumenti Registration form, sipas linkut:
<https://forms.gle/CpsFrUnr6DF1SwRdA>
- Plani i mobilitetit për mësimdhënie/trajnim*;

**Për të shkarkuar formatin e Planit të Mobilitetit për mësimdhënie klikoni në adresën:
http://www.unitir.edu.al/images/Mobility_Agreement_Teaching_outgoing.docx*

**Për të shkarkuar formatin e Planit të Mobilitetit për trajnim klikoni në adresën:
http://www.unitir.edu.al/images/Mobility_Agreement_Training_outgoing.docx*

Afati për aplikim: **25 Shkurt 2020**

Dokumentet duhen dorëzuar dorazi në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë dhe Studentët, Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë nga e Hëna në të Enjte ora 10:30 – 11:30 dhe 14:30 – 16:00, si dhe duhet të dërgohen të skanuara në e-mailin iro@unitir.edu.al.

Për më shumë informacion mbi bursat mund të na kontaktoni në Sektorin për Marrëdhëniet me Jashtë në adresën: iro@unitir.edu.al

Universiteti i Tiranës ju uron suksese në aplikimin tuaj!